




REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
 AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
 AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
 ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. 2-D/DPK
 Nr. Prot. 01-2823/14
 Br. Prot. Prot No
 Nr. i faq. 02
 Data 11.08.2014
 Broj stranica
 Datum
 Nr. pages
 Date

PRISHTINE



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 01.08.2014, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK– 03-2174/14, për z. Bajram Tërshani, Këshilltar Komunal ne Kuvendin Komunal të Suharekës, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt te interesit me numër protokolli AKK–03-2174/14, qe për trajtim ka pas zyrtarin e lartë z. Bajram Tërshani, Këshilltar Komunal ne Kuvendin Komunal të Suharekës.

Gjatë zhvillimit të procedurës dhe analizimit të gjendjes është konstatuar se zyrtari i lartë, gjatë kohës se ushtrimit të funksionit publik si, Këshilltar Komunal ne Kuvendin Komunal të Suharekës është identifikuar se ka te regjistruar një biznes privatë dhe ushtron edhe funksione tjetra ne këtë veprimtari private, e që sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik Nr.04/L-051, kjo situatë paraqet konflikt të mundshëm të interesit, dhe mos pajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik, andaj Agjencia kundër Korrupsionit me datën 07.07.2014. e ka njoftuar zyrtarin e lartë me shkresën e parë se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejtë në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet qe posedon Agjencia.

Pas këtyre procedurave, z. Bajram Tërshani, Këshilltar Komunal ne Kuvendin Komunal të Suharekës, pasi ka kontaktuar me zyrtarët e Agjencisë ka kërkuar qe ti behet një sqarim lidhur me situatën e dyshuar për konflikt të mundshëm te interesit.

Zyrtarët e Agjencisë ne takimin qe është mbajtur me z.Tërshani, e kanë njoftuar me faktet qe posedon Agjencia, lidhur me konfliktin e mundshëm të interesit ne ushtrim te funksionit publik, ndërsa, z. Tërshani është pajtuar me gjendjen dhe është zotuar se biznesi nuk zhvillon aktivitet dhe se ne afat sa me te shpejt do te bej ndryshimet e nevojshme dhe do te shmanget nga situata e mundshme e konfliktit te interesit.

Me datën 21.07.2014, z. Bajram Tërshani, ka sjellë ne Agjenci dokumentin zyrtar te lëshuar nga ARBK-ja, ku dëshmohet se janë ber ndryshimet e kërkuara dhe se ne biznesin privat me emër N.SH.T “B&B INFINIT “ zyrtari ne fjale ka autorizuar një person tjetër.

Vlerësojmë se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e mundshme te konfliktit të interesit në të cilën ndodhej

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari kontaktues)

Hasan Preteni
Drejtör i Agjencisë kundër Korrupsionit

